

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Fakulteti Filozofik		
Titulli i lëndës:	Sociologjia e identitetit		
Niveli:	Bachelor		
Statusi i lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	III		
Numri i orëve në javë:	3 + 2		
Vlera në kredi – ECTS:	7		
Koha / lokacioni:			
Mësimdhënësi i lëndës:	Asst. Dr. Artan Krasniqi		
Detajet kontaktuese:	Email: artan.krasniqi@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës			
	Moduli ofron njohuri themelore nga fusha e Sociologjisë së identitetit; për format dhe modelet e shfaqjes së tij në kontekste të ndryshme shoqërore; për identitetin personal, familjar, etnik, kombëtar, kulturor, gjinor, shtetëror, etj. Do të fitohen njohuri për interaksionet individuale dhe kolektive në kontekst edhe të gërshetimit të këtyre identiteteve në shoqërinë bashkëkohore (globale, nacionale).		
Qëllimet e lëndës:	Studimi teorik dhe praktik me qëllim të ngritjes dhe zgjerimit të dijes së studentëve lidhur me format e identitetit. Të aftësohen për të argumentuar dhe shprehur shkathtësitë akademike dhe praktike në konceptimin e drejtë të fenomenit të identitetit.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Të shprehë shkathtësitë e vlerësimit dhe interpretimit kritik; Të studiojë dhe hulumtojë në fushën e sociologjisë së identitetit; Të transmetojë dijen në ambient akademik; Të publikojë shkrimet autoriale në periodik.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet			2
Ushtrime në terren			
Kollokfiume, seminare	3	5	15
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	21	63
Përgatitja përfundimtare për provim			15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz,			3

provim final)			
Projektet,prezantimet ,etj			2
Totali			175
Metodologjia e mësimit:	Ligjërata, diskutime, punë në grupe, punë individuale, metoda ndërvepruese të mësimit		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi gjithësemestral: 35 % testi i parë 35 % testi i dytë 20 % projekti hulumtues, 10 % vijimi i rregullt aktiv.		
Literatura			
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. George Herbert Mead, <i>"Mendja, qenia dhe shoqëria"</i>, Dija, Prishtinë, 2001 2. Anne Marie Thiesse, <i>"Krijimi i identiteteve kombëtare (Evropa e shek. XIII-XX)"</i>, Dukagjini, 2004, Pejë 3. Ernest Gellner, <i>"Kombet dhe nacionalizmi"</i>, Prishtinë, 2009 4. Samuel P. Huntington, <i>"Përleshja e civilizimit"</i>, Prishtinë, 2004 5. Meridith B. McGuire, <i>"Religjioni, konteksti shoqëror"</i>, Logos A, 2007 6. Anthony Giddens, <i>"Sociologjia"</i>, Tiranë, 1997 7. Ibrahim Berisha, <i>"Konvergjencia intelektuale"</i>, Prishtinë, 2009 8. Simon, Bernd, <i>"Identity in Modern Society"</i>, Plackwell Publishing, 2004 9. Lexime nga <i>"Libri i Sociologjisë"</i> <ol style="list-style-type: none"> a. N. Elias: <i>Procesi qytetërues ecën përpara pa u ndalur;</i> b. E. Gofman: <i>Stigma është tipar poshtërues;</i> c. S. Holl: <i>Identitetet moderne po shqendërzohen.</i> 		
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Bernd Simon, <i>"Identity in modern society: a social psychological perspective"</i>, Blackwell Publishing Ltd, Library of Congress, 2004 2. Mayo, Marjorie, <i>"Cultures, Communities, Identities"</i>, PALLGRAVE MACMILAN, 2000 3. Gani Bobi, <i>"Paradoks kulturor"</i>, Rilindja, Prishtin 4. Derek Layder, <i>"Social and Personal Identity, Understanding Your Self"</i>, SAGE Publications, 2004 5. Ismajl Hasani, <i>"Vetëdija kombëtare dhe fetare tek shqiptarët"</i>, Universiteti i Prishtinës, 2001 		

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet

Java e parë:	Prezantimi lëndës dhe metodave të punës
Java e dytë:	Konceptet themelore për identitetin - Konvergjimi teorik në trajtimin e identitetit (sociologjik, antropologjik, psikologjik, historik, filozofik, politik)
Java e tretë:	Uni dhe vetja; Identiteti personal
Java e katërt:	Stigma; Paragjykimet dhe stereotipat; Uniformiteti dhe shmangia
Java e pestë:	Identiteti kolektiv; Identiteti i shumëfishtë; Shqendërzimi i identiteteve
Java e gjashtë:	Identiteti dhe kultura; Qytetërimi
Java e shtatë:	Testi i parë i ndërmjetëm
Java e tetë:	Identiteti gjinor dhe seksual
Java e nëntë:	Identiteti i moshës, statusit social dhe profesionit; aftësia fizike
Java e dhjetë:	Raca, etnia dhe kombi
Java e njëmbëdhjetë:	Feja, diversiteti dhe dallimet
Java e dymbëdhjetë:	Identiteti rajonal; Qyteti dhe fshati; Normat dhe vlerat lokale
Java e trembëdhjetë:	Identiteti shtetëror; politik
Java e katërbëdhjetë:	Identiteti virtual; privatësia dhe shpërfaqja; Inteligenca Artificiale
Java e pesëmbëdhjetë:	Testi i dytë i ndërmjetëm

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Cakto politikat e mirësjelljes konform statusit të UP-së.

Studentët duhet t'u përmbahen këtyre kriterëve dhe rregullave të mirësjelljes: vijimi i rregullt në ligjërata dhe ushtrime, mbajtja e qetësisë në klasë, shkyçja e telefonave celularë, hyrja në sallë me kohë, etj.